SHABAN ÇUPI:

TRASHËGIMIA ARKEOLOGJIKE E HANIT TË ELEZIT

FESTIVALI CROSSROADS –UDHËKRYQI I KUJTESËS

20 KORRIK 2025

Nga data 18-20 korrik të vitit 2025, në Han të Elezit, u organizua (për herë të parë) Festivali CROSSROADS - UDHËKRYQI I KUJTESËS, duke përfshirë shumë aktivitetit brenda tij. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, në ditën e tretë u organizua një Tryezë shkencore për trevën e Hanit të Elezit ku morën pjesë panelistë të fushave të ndryshme e në mesin e tyre edhe Gjeneral Kudusi Lama

STELLAT ARKEOLOGJIKE SI DËSHMI E AUTOKTONISË ILIRE

Në antikë, krahas rrugës Lissus-Theranda-Ulpiana-Vendenis-Naissus që e përshkonte Dardaninë e lashtë, ka funksionuar edhe rruga tjetër jug-veri, e cila kalonte Selanik-Scupi dhe nëpër vendbanimin e Hanit të Elezit vazhdonte në Ulpiana-Vicianium-Municipium dhe vazhdonte më tej në veri dhe, siç thotë arkeologia e shquar Edi Shukriu ,, *Pjesë të trasesë rrugore Viciano–Scupi janë gjetur te Hani i Elezit, bashkë me dy miljëtregues të kohës së (perandorëve) Hadrianit dhe Antonin Piut"* (Shekulli II plotësimi ynë). Në fshatin Paldenicë, gjatë vitit 1967 u gjet edhe një brezore femrash e punuar me një teknikë nga qelqi, e cila si një relikt me vlerë të veçantë arkeologjike, gjendet edhe në Guidën Arkeologjike të Kosovës. Krahas këtyre gjetjeve ,,*në kishën e dikurshme të fshatit Dërmjak, në vendin e quajtur Zitina, në lindje të fshatit, është gjetur kryqi i kishës së këtij vendbanimi dhe është dërguar me tren për Beograd. Para disa viteve është gjetur një statujë e një gruaje prej guri me madhësi prej 2 m, që padyshim dëshmon për një vendbanim të vjetër të periudhës romake".* (Dr.Jusuf Osmani ,, Vendbanimet e Kosovës-Kaçaniku" fq. 91)

Kjo pllakë arkeologjike është zbuluar në vitin 1995 nga Zeqir Thaçi, tanimë i ndjerë. Pllaka u zbulua në fshatin Paldenicë në Lagjen e Thaçëve. Pllaka, përkatësisht stella arkeologjike është e vendosur në oborr të shkollës fillore ,,Kështjella e Diturisë" në fshatin Paldenicë.
Pllaka është e shekullit III të erës sonë dhe si e tillë dëshmon se që në këtë shekull treva e Hanit të Elezit ka qenë e banuar.
Përmbajtjen e pllakës, përkthyer nga arkeologia Elvana Bushi, nga latinishtja në shqip ka këtë përmbajtje:
Markcus Julius Fuscus ka vdekur në moshën 75 vjeçare.
Annia Justa ka vdekur në moshën 40 vjeçare.
Po ashtu, Valeria Varia e vendosur poshtë, është e varrosur këtu.
Marcus Julius Clemens, i biri, prindërve të merituar u ngrit këtë monument.

Më 6 nëntor 1980, në Kaçanik u gjetë një stellë arkeologjike e cila përkthyer në shqip nga Prof. dr. Zef Mirdita, ka këtë përmbajtje:
Shpirtërave të përmortshëm M. Kocceius Viator që jetoi 55 vjet. Ulpia Annia që jetoi 35 vjet këtu pushojnë. Kokeius Ingenus prindërve të përshpirtësh ua ngrit.
Në vazhdim, Prof.dr. Zef Mirdita, me një shkrim të zgjeruar, trajton kuptimin e kësaj pllake ku ndër tjera thotë se: *edhe vetë emrat janë karakteristikë për vendasit, sidomos emri ANNIA që merret prej gjithë linguistëve si emër ilir dhe që në Dardani është mjaft i pranishëm, ndërsa sa i përketë kohës,* profesor Zef Mirdita thotë se, *kjo pllakë është e shekullit II të erës sonë.* (Burimi: Një stellë mbivarrore e zbuluar në Kaçanik, gazeta Rilindja 22 .11. 1980, Prof.dr. Zef Mirdita)
Tani krahasojmë stellën në fshatin Paldenicë dhe tjetrën në Kaçanik. Nga të dy stellat arkeologjike është karakteristikë emri ANNIA e që sipas profesorit Zef Mirdita është emër ilir.

FIG. 1

- **ARTEFAKTET ARKEOLOGJIKE JANË GJETUR RASTËSISHT NË FSHATIN PALDENICË TË HANIT TË ELEZIT DHE NË KAÇANIK**
- **PLLAKA ARKEOLOGJIKE NË PALDENICË ËSHTË GJETUR NË VITIN 1995**
- **PLLAKA ARKEOLOGJIKE NË KAÇANIK ËSHTË GJETUR NË VITIN 1980**
- **JANË TË SHEKULLIT II DHE III TË E.S**

- **EMËRUES I PËRBASHKËT I PLLAKAVE ËSHTË EMRI ANNIA**
- **NGA TË GJITHË LEKSIKOLOGËT, ËSHTË KONSTATUAR SE EMRI ANNIA ËSHTË EMËR ILIR**
- **KËTO PLLAKA ARKEOLOGJIKE, DËSHMOJNË SE KJO TREVË ISHTE E BANUAR QË PARA DY MIJË VJETËVE DHE NË ANËN TJETËR DËSHMOJNË AUTOKTONINË TONË ILIRE NË KËTË TREVË.**
- **PLLAKA E PALDENICËS RUHET NË OBORR TË SHKOLLËS NË FSHATIN PALDENICË**
- **PËR VLERËN QË, KJO PLLAKË-STELLË ËSHTË PËRFSHIRË NË GUIDËN ARKEOLOGJIKE TË KOSOVËS**
- **PLLAKA NË KAÇANIK ËSHTË NË SHTËPINË E KULTURËS**

REKOMANDIM: DUKE PASUR PARASYSH VLERËN HISTORIKE TË PLLAKËS, INSTITUCIONI KOMUNAL NË HAN TË ELEZIT TË MERR NË MBROJTJE LIGJORE PLLAKËN ARKEOLOGJIKE NË FSHATIN PALDENICË

MILJETREGUESIT

- **KRAHAS PLLAKAVE ARKEOLOGJIKE, NË KËTË TREVË JANË GJETUR EDHE DY MILJETREGUES**
- **MILJETREGUESIT DHE PJESA E TRASESË JANË GJETUR NË AFËRSI TË PARKUT TË SOTËM TË QYTETIT „ISA BERISHA''**
- **MILJETREGUESIT JANË TË KOHËS SË PERANDORIT ROMAK HADRIANIT DHE ANTONIO PIUT TË SHEKULLIT II TË E.S.**
- **PËR KËTO MILJETREGUES KA SHKRUAR ARKEOLOGIA EDI SHUKRIU**
- **NUK DIMË SE KU GJENDEN TANI KËTO OBJEKTE**

REKOMANDIM INSTITUCIONAL:

MILJETREGUESIT DUHET KËRKUAR NË INSTITUTIN ARKEOLOGJIK TË KOSOVËS

SPIRALJA KONCENTRIKE

FIG. 2

- **SPIRALJA KONCENRIKE ËSHTË NJË SIMBOL ILIR.**
- **ËSHTË GJETUR NË VENDE TË NDRYSHME TË KOSOVËS**
- **NË HAN TË ELEZIT ËSHTË GJETUR NË DY RASTE, NË NJË VARR TË KRISHTERË DHE TE NJË GURË VARRI MUSLIMAN**
- **NË NJË VARR GRUAJE TË KRISHTERË ËSHTË GJETUR SI MJET DEKORATIV.**
- **POS SPIRALES, NË VARR JANË GJETUR EDHE RELIKTE TË TJERA, SI: UNAZË, SHTIZË E MONEDHA.**
- **JANË GJETUR NË LAGJEN E THAÇËVE NË FSHATIN PALDENICË, NË KORRIK TË VITIT 2013 DHE I KA MARRË NË TRAJTIM TË MËTEJMË INSTITUTI ARKEOLOGJIK I KOSOVËS**
- **PO NË FSHATIN PALDENICË, SPIRALJA KONCENTRIKE ËSHTË GJETUR EDHE NË NJË GURË VARRI MUSLIMAN**

- **NË NIVEL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, SPIRALJA KONCENTRIKE ËSHTË LOGOJA E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE TË KOSOVËS.**

  ÇKA SIMBOLIZON SPIRALJA KONCETRIKE?

- **SIMBOLIZON BURIMIN E JETËS, JETA FILLON NGA QENDRA DHE VAZHDON**
- **RRUGËTIMIN NGA LINDJA NË VDEKJE**
- **CIKLIN E DIJES E CILA FILLON FILLON NGA QENDRA DHE ZHVILLOHET NË PAFUNDËSI**
- **ME NJË FJALË:**
- **SPIRALJA KONCENTRIKE ËSHTË BURIM I JETËS DHE I DIJES**

REKOMANDIM: DUKE PASUR PARASYSH VLERËN QË KA KJO SPIRALE, KËTO RELIKTE DUHET KËRKUAR NË INSTITUTIN ARKEOLOGJIK TË KOSOVËS

PLOTËSIM REKOMANDIMI:

MEQENËSE SPIRALJA KONCENTRIKE SHQUHET PËR NJË VLERË TË MADHE HISTORIKE NGA TRASHËGIMIA JONË DHE PO E NJEJTA NA NDËRLIDHË EDHE ME LOGON E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE „PJETËR BOGDANI'' NË PRISHTINË, PROPOZOJ QË KJO SIMBOLIKË TË ZË VEND TË MERITUAR NË INSTITUCIONIN KOMUNAL TË HANIT TË ELEZIT.

SVASTIKA

FIG 3

- **SVASTIKA ËSHTË SIMBOL I DIELLIT, DRITËS DHE JETËS**
- **ËSHTË GJETUR NË GURË VARRI MUSLIMAN NË FSHATIN PALDENICË**
- **DUKE KRAHASUAR SIMBOLIN E GJETUR ME VENDE TË TJERA, SVASTIKA ËSHTË GJETUR EDHE NË KALANË E SHKUPIT, NË KALANË E JUSTINIANIT**
- **KY SIMBOL ËSHTË KEQPËRDORUR NGA NAZIZMI**

BREZORET

Rrip - brezore, e zbukuruar në teknikën millefiori një teknikë e veçantë e punuar në qelq. Është gjetur në fshatin Paldenicë të Hanit të Elezit në vitin 1967. Është përfshirë në Guidën Arkeologjike të Kosovës.

FIG. 4

- **RRIP- BREZORE E GJETUR NË VITIN 1967 NË FSHATIN PALDENICË.**
- **ËSHTË E PUNUAR NGA QELQI.**
- **PËR VLERËN QË KA ËSHTË PËRFSHIRË NË GUIDËN ARKEOLOGJIKE TË KOSOVËS**

REKOMANDIM INSTITUCIONAL:

BREZOREN DUHET KËRKUAR NË INSTITUTIN ARKEOLOGJIK TË KOSOVËS

JU FALEMINDERIT!

Po kush ishin panelistët pjesëmarrës në Tryezën e parë shkencore për trevën e Hanit të Elezit që u mbajt më 20 korrik 2025?

1. Gjeneral Kudusi Lame
2. Elvana Bushi
3. Shaban Çupi
4. Mehmet Ballazhi
5. Safet Bushi
6. Remzi Ballazhi
7. Bedri Bushi
8. Halim Ballazhi

Moderator i Tryezës: Altin Kalisi
Drejtor i Festivalit: Armend Ballazhi
Secili nga të pranishmit kishin tema të caktuara, qoftë nga arkeologjia, lufta çlirimtare, arsimi, sporti, hajkingu si dhe rrëfime nga e kaluara e trevës.

PJESËMARRËSIT E TRYEZËS SHKENCORE, ILUSTRUAR NËPËRMJET FOTOGRAFISË